TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 294
Dt. 30 APR 2013
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

N.SH." Eco & Conto "
Kompani Ligjore e Auditimit

Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës "Trainkos" sh.a.

Raport Final i Auditorit të Pavarur

Pasqyrat Financiare

31 Dhjetor 2012

Prill, 2013

P ë r m b a j t j a

-Raporti i auditorit të pavarur 4-5

Informata të përgjithshme rreth kompanisë.....6

-Pasqyrat financiare.....7-15

Pasqyrat e politikave kontabël dhe shpalosjet financiare.....16-30

-Fushveprimi , Objektivat dhe shtrirja e auditimit.....31

Shkurtesat e përdorura:

HK- Hekurudhat e Kosovës

SNA- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

SNK- Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

ATK- Administrata Tatimore e Kosovës

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR
Bordit të Drejtorëve të Kompanisë
Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës "Trainkos" sh.a.

Objekti i Auditimit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të kompanisë Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës "Trainkos" sh.a . Auditimi ynë përfshinë Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2012, Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e Ndryshimeve në Ekuitet dhe Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për periudhën 01.Janar deri më 31.Dhjetor 2012, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me standardet e raportimit financiar të aplikueshme në Kosovë. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, realizimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të liruara, nga gabimet apo mashtrimet e mundshme; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në kryerjen e auditimit. Përpos asaj që diskutohet në paragrafin në vijim, ne kemi kryer auditimin në përputhje me standardet e auditimit të cilat aplikohen në Kosovë.
Këto standarde kërkojnë planifikimin dhe kryerjen e auditimit, me qëllim të shprehjes së një mendimi se pasqyrat financiare nuk përmbajnë parregullsi, dhe janë të liruara nga keq pohimet dhe gabimet materiale, respektivisht mashtrimet eventuale. Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.
Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.

Baza për dhënien e opinionit

Siç është shpalosur në shënimin 5 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2012, vlera neto e pronës, impianteve dhe pajisjeve të Kompanisë është në shumë prej 6,962.235 Euro neto. Sipas politikave të pranuara të kontabilitetit të shpalosura më tej në Shënimin 2 të Pasqyrave Financiare, Prona, Impiantet, dhe Pajisjet ekzistuese më 1 Shtator 2011, janë bartur bazuar në vendimin e komisionit për ndarje të aseteve të "Hekurudhat e Kosovës" SH.A. me shumat e tyre të rivlerësuara, të përcaktuara nga vlerësuesit e pavarur të jashtëm. Këto asete janë bartur si salldo fillestare të aseteve me rastin e hapjes së bilancit të gjendjes. " Trainkos" sh.a.
Nga fakti se nga auditorët paraprak u paraqit rezerva lidhur me saktësinë e vlerës së aseteve, për të cilat, rezultati i aplikimit të procedurave tona standarde dhe alternative nuk na mundëson të bindim veten tonë me saktësinë e tyre, preferohet që të rivlerësohet vlera bartëse e pasurisë, impianteve dhe pajisjeve nga vlerësues të jashtëm. Po ashtu ne nuk arritëm të bindim veten tonë mbi harmonizimin e plotë të gjendjes se aktiveve afatgjata materiale sipas librave kontabël dhe komisionit të regjistrimit të këtyre pasurive.

Siç është shpalosur më tej në Shënimin 6 në pasqyrat financiare shoqëruese më 31 Dhjetor 2012, stoqet gjegjësisht rezervat në depot e kompanisë nga evidenca kontabël nuk përkojnë plotësisht me regjistrat e komisionit për regjistrim të këtyre pasurive

Siç është shpalosur më tej në Shënimin 7 në pasqyrat financiare shoqëruese më 31 Dhjetor 2012, llogaritë e arkëtueshmet tregtare të kompanisë janë në shumën prej 1,671,908 Euro, të bartura si salldo fillestare me rastin e ndarjes dhe të faturuara gjatë kësaj periudhe. Rezultati i punës së komisionit të llogarive të arkëtueshme gjatë aktivitetit auditues ende nuk ishte kompletuar dhe azhurnuar në evidencat kontabël. Pastrimi i regjistrave pritet te behet pas aprovimit te raportit te ketij komisioni dhe vertetimit te saktësise se tyre për secilin klient.

Opinioni i Auditorit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të "Trainkos" sh.a., pozicioni financiar i kompanisë më 31 Dhjetor 2012 dhe performansa e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedha e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me standardet e konabilitetit dhe SNA-të te aplikueshme në Kosovë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si Theksim i çështjes është : Regjistri i Aktiveve Afatgjata Materiale, ndonëse në evidence kontabël udhëhiqen sipas vlerësimit para ndarjes (rivlerësimi nuk ka ndodhur), nuk jemi bindur mbi harmonizimin e gjendjes sipas librave me regjistrat e komisionit te regjistrimit. Azhurnimi dhe harmonizimi i gjendjes së Llogarive të Arkëtueshme në evdenca kontabël me raportin e komisionit të arkëtueshmeve , dhe gjendja e stoqeve ne fund sipas librave dhe sipas komisionit per regjistrim.

N.SH." Eco & Conto "

ECO&CONTO FERIZAJ

22 Prill, 2013

1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

TRAINKOS sh.a. ("Shoqëria") është kompani aksionare e inkorporuar më 16 Gusht 2011 në datën e regjistrimit dhe sipas Regjistrimit të Biznesit të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë më datë 23 Gusht 2011 me numër regjistrimi të biznesit 70773120, kapitali i përgjithshëm i regjistruar kap shumën e 25,000 Euro. Ai përbëhet nga 25 mijë aksione të zakonshme me çmim prej 1 euro për aksion. Adresa e regjistruar dhe vendi kryesor i biznesit, TRAINKOS sh.a. është Fushë Kosovë. Pronare kryesore e kompanisë është Qeveria e Kosovës.

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 33 paragrafi 1, të Ligjit mbi Hekurudhat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-076, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr.01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 26 Shkurt 2010 mori Vendim mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës sh.a.

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087, për "Kompanitë Publike"; Ligjit Nr.02/L-123, për "Shoqëritë Tregtare" dhe bazuar në vendimin e Qeverisë nr.05/110 të datës 26.02.2010 për ndarjen e Hekurudhave të Kosovës sh.a. themelon: "Shoqërinë Aksionare " Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës" sh.a. me numër të biznesit 70773120, e cila është përgjegjëse për pasuritë, detyrimet, që rrjedhin si pasojë e këtij transformimi. Shkurtesa e emërtimit është "TRAINKOS" sh.a.

Selia e kompanisë gjendet në Komunën e Fushë Kosovës "Sheshi i Lirisë" pn. Kompania mund të zhvilloj aktivitetin e saj në territorin e Kosovës dhe jashtë saj.
Kompania, sipas Statutit të saj dhe Legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës mund të hapë Qendra zyra përfaqësuese, filiale, degë dhe kompani të tjera si në Republikën e Kosovës ashtu edhe jashtë vendit.

Shpërbërja(ndarja) financiare e Hekurudhave të Kosovës sh.a. është bërë nga grupi punues i përbërë prej tetë anëtarëve bazuar në vendimin e dates 18.05.2010 Nr.571. në bazë të cilit vendim është bërë ndarja e mjeteve financiare, ndarja e borxheve dhe ndarja e obligimeve financiare në dy kompani të reja ("INFRAKOS" sh.a dhe "TRAINKOS" sh.a.)

Aktivitetet biznesore të kompanisë

Aktiviteti kryesor i kompanisë është transporti i mallrave dhe shërbimet hekurudhore të udhëtarëve në baza komerciale. Rrjeti hekurudhor përbëhet prej rreth 333 km pa binar elektrifikues. Linja kryesore shkon Veri -Jug duke lidhur Maqedoninë me kufirin e Serbisë, në veri të Mitrovicës. Një linjë më tej shkon në drejtim të perëndimit nga Prishtina në Pejë dhe në drejtim të Lindjes nga Prishtina në Podujevë (Merdare-kufi me Serbinë).

Emri i kompanisë: "Trainkos" sh.a.
Numri fiskal: 600704101
Adresa: Sheshi i Lirisë pn
Komuna: Fushë Kosovë

RAPORTI FINANCIAR VJETOR PËR SHOQËRITË TREGTARE

BILANCI I GJENDJES

"TRAINKOS" sh.a.

Më datën 31 Dhjetor 2012

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			2012	2011
	PASURITË			
A	**KAPITALI I THIRRUR I PAPAGUAR**			
B	**PASURITË JOQARKULLUESE (I+II+III+IV)**		**6,962,235.00**	**7,511,586.00**
I	**PASURITË E PAPREKSHME (1 deri 4)**		**0.00**	**0.00**
1	Kostot e zhvillimit			
2	Patentat, licencat, markat tregtare, softueri dhe të drejtat tjera			
3	Emri i mirë (Goodwilli)			
4	Pasuritë tjera të paprekshme			
II	**PASURITË E PREKSHME (1 deri 7)**		**6,962,235.00**	**7,511,586.00**
1	Toka		229,680.00	229,680.00
2	Objektet ndërtimore		975,530.00	934,271.00
3	Pajisjet dhe makineritë		5,687,270.00	6,347,635.00
4	Veglat, inventari i repartit dhe mjetet transportuese		69,755.00	
5	Pasuritë biologjike			
6	Pasuritë tjera të prekshme			
7	Investimet në patundshmëri			
III	**PASURITË FINANCIARE JOQARKULLUESE (1 deri 6)**		**0.00**	**0.00**

1	Aksionet tek filialat			
2	Huatë e dhëna ndërmarrësve të ndërlidhur			
3	Investimet në ortakëri			
4	Investimet në letra me vlerë			
5	Huatë e dhëna, depozitat dhe të ngjashme			
6	Pasuritë tjera financiare joqarkulluese			
IV	**PASURITË E SHTYRA TATIMORE**			
C	**PASURITË QARKULLUESE (I+II+III+IV)**		**3,941,289.78**	**1,819,566.00**
I	**STOQET (1 deri 5)**		**622,331.93**	**756,771.00**
1.	Lënda e parë dhe materiali		622,331.93	756,771.00
2.	Prodhimtaria në vijim			
3.	Produktet e gatshme			
4.	Mallrat e listuara në burse			
5.	Pasuritë tjera qarkulluese për shitje			
II	**LLOGARITË E ARKËTUESHME (1 deri 6)**		**1,780,218.74**	**643,002.00**
1.	Llogaritë e arkëtueshme nga filialat			
2.	Llogaritë e arkëtueshme tregtare		1,671,908.90	643,002.00
3.	Llogaritë e arkëtueshme nga filialet		92,185.53	
4.	Llogaritë e arkëtueshme nga punëtorët			
5.	Llogaritë e arkëtueshme nga shteti dhe institucionet tjera		4,728.56	
6.	Llogaritë tjera të arkëtueshme		11,395.75	
III	**PASURITË FINANCIARE QARKULLUESE (1 deri 6)**		**1,081,014.11**	**419,793.00**
1.	Aksionet tek filialat			
2.	Huatë e dhëna ndërmarrësve të ndërlidhur			
3.	Investimet në ortakëri			
4.	Investimet në letra me vlerë			
5.	Avanset e dhëna, depozitat dhe të ngjashme		1,081,014.11	
6.	Pasuritë tjera financiare joqarkulluese			
IV	**PARATË NË BANKË DHE ARKË**		**457,725.00**	**419,793.00**
E	**GJITHSEJT PASURITË (A+B+C+D+E)**		**10,903,524.78**	**9,331,152.00**
F	**ZËRAT JASHTËBILANCORË**			
	EKUITETI AKSIONAR, REZERVAT DHE DETYRIMET			
A	**EKUITETI AKSIONAR DHE REZERVAT (I+II+III+IV+V+VI+VII)**		**4,413,774.85**	**4,125,463.00**
I	**KAPITALI THEMELUES (I REGJISTRUAR)**		**25,000.00**	**25,000.00**
II	**KAPITALI REZERVË**		**4,780,123.04**	**4,020,964.00**
III	**REZERVAT NGA FITIMI (1 deri 4)**		**0.00**	**0.00**
1.	Rezervat ligjore			
2.	Rezerva për aksionet vetjake			
3.	Rezervat statutore			
4.	Rezervat tjera			
IV	**REZERVAT E RIVLERËSIMIT**			

V	FITIMET/HUMBJET E BARTURA		79,499.00	
VI	FITIMI APO HUMBJA E VITIT FINANCIAR		-470,847.19	79,499.00
VII	INTERESI MINORITAR			
B	DETYRIMET AFATGJATA (1 deri 8)		6,448,915.76	5,205,690.00
1	Obligimet ndaj filialave			
2	Obligimet për hua, depozita dhe të ngjashme		5,411,741.11	4,897,734.00
3	Obligimet ndaj bankave dhe institucioneve tjera financiare			
4	Obligimet afatgjata për avance			
5	Llogaritë e pagueshme tregtare		787,174.65	57,956.00
6	Obligimet për letra me vlerë			
7	Llogaritë tjera të pagueshme		250,000.00	250,000.00
8	Detyrimet e shtyra tatimore			
C	DETYRIMET AFATSHKURTA (1 deri 11)		40,834.17	0.00
1	Obligimet ndaj filialave			
2	Obligimet për hua, depozita dhe të ngjashme			
3	Obligimet ndaj bankave dhe institucioneve tjera financiare			
4	Obligimet afatgjata për avance			
5	Llogaritë e pagueshme tregtare			
6	Obligimet për letra me vlerë			
7	Llogaritë tjera të pagueshme		20,636.87	
8	Obligimet ndaj të punësuarëve		522.25	
9	Obligimet për tatime dhe contribute		19,675.05	
10	Obligimet ndaj aksionarëve për dividend			
11	Obligimet tjera afatshkurta			
D	GJITHSEJ EKUITETI AKSIONAR, REZERVAT DHE DETYRIMET (A+B+C+D)		10,903,524.78	9,331,153.00
E	ZËRAT JASHTË BILANCIT			
	Vetëm për Raportet e konsoliduara			
A	EKUITETI AKSIONAR DHE REZERVAT			
1	Iu takon pronarëve te kompanisë meme			
2	I takon interesit minoritar			

31.03.2013
F. Kosovë

Z. Betim Gjoshi
Kryeshef ekzekutiv

Z. Zair Imeri
Zyrtar kryesor financiar

II. PASQYRA E TË ARDHURAVE

Për periudhën 01.01.2012 **Deri** 31.12.2012

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
				2,011.00
I	**TE HYRAT (1 deri 3)**		**5,052,629.00**	**2,092,988.00**
1	Të hyrat nga shitja		4,485,622.00	1,542,996.00
2	Të hyrat nga përdorimi i produkteve, mallrave dhe shërbimeve			
3	Të hyrat tjera afariste		567,007.00	549,992.00
II	**SHPENZIMET (1 deri 7)**		**5,523,476.19**	**2,004,656.00**
1	Zvogëlimi i vlerës së stoqeve			
2	Rritja e vlerës së stoqeve			
3	Shpenzimet e materialit (a+b+c)			
	a) Materiali dhe lënda e pare			
	b) Shpenzimet e mallit të shitur		3,064,597.00	899,368.15
	c) Shpenzimet tjera			72,580.00
4	Shpenzimet e pagave (a+b)		1,382,906.00	419,539.99
	a) Pagat dhe meditjet bruto		1,297,364.34	398,563.04
	b) Kontributi për sig.pens/Punëdhënës		85,541.66	20,976.95
5	Zhvlerësimi		720,016.19	153,977,76
6	Shpenzimet tjera		355,957.00	39,650.11
7	Shpenzimet tjera afariste			
III	**TE ARDHURAT FINANCIARE (1 deri 5)**		**0.00**	**0.00**
1	Kamatat, diferencat e kursit, dividentat dhe të ardhurat e ngjashme nga filialat			
2	Kamatat, diferencat e kursit, dividentat dhe të ardhurat e ngjashme nga të tjerët			

3	Pjesa e të hyrave nga filialat			
4	Fitimi i parealizuar			
5	Të ardhurat tjera financiare			
IV	**TË DALAT FINANCIARE (1 deri 4)**		**0.00**	**0.00**
1	Kamatat, diferencat e kursit, dividentat dhe të ardhurat e ngjashme nga filialat			
2	Kamatat, diferencat e kursit, dividentat dhe të ardhurat e ngjashme nga të tjerët			
3	Humbja e parealizuar			
4	Të dalat tjera financiare			
V	**Të ardhurat tjera të pazakonshme**			
VI	**Të dalat tjera të pazakonshme**			
VII	**GJITHSEJ TË ARDHURAT (I+III+V)**		**5,052,629.00**	**2,092,988.00**
VIII	**GJITHSEJ SHPENZIMET (II+IV+VI)**		**5,523,476.19**	**2,004,656.00**
IX	**FITIMI PARA TATIMIT (VII-VIII)**		**-470,847.19**	**88,332.00**
X	**HUMBJA PARA TATIMIT (VIII-VII)**		**470,847.19**	**-88,332.00**
XI	**TATIMI NË FITIM**			**8,833.20**
XII	**FITIMI NETO (IX-XI)**		**-470,847.19**	**79,498.80**
XIII	**HUMBJA E PERIUDHËS (X+XI) ose (XI-IX)**			
	Vetëm për Raportet e konsoliduara			
A	**FITIMI/HUMBJA E PERIUDHËS**			
1	Iu takon pronarëve te kompanisë mëmë			
2	I takon interesit minoritar			

31.03.2013
F. Kosovë

Z. Betim Gjoshi
Kryeshef ekzekutiv

Z. Zair Imeri
Zyrtar kryesor financiar

III. PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Për periudhën 01.01.2012 **Deri** 31.12.2012

METODA DIREKTE

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues	Viti i kaluar
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE				
1	Arkëtimet e parasë nga blerësit		3,983,180.30	1,377,264.00
2	Arkëtimet e parasë nga honoraret, tarifat, komisionet e të ngjashme			
3	Arkëtimet e parasë nga sigurimi për kompensim dëmi			
4	Arkëtimet e parasë nga rimbursimi i tatimit			
5	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet operative			
I	**GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE (1 deri 5)**		**3,983,180.30**	**1,377,264.00**
1	Pagesat e parasë për furnitorët		-2,557,613.74	-937,140.00
2	Pagesat e parasë për të punësuarit		-1,382,900.00	-462,069.00
3	Pagesat e parasë			

	për sigurimin për kompensimin e dëmeve			
4	Pagesat e parasë për interes			
5	Pagesat e parasë për tatime		-4,728.56	-8,833.00
6	Pagesat e tjera të parasë për aktivitetet operative			0.00
II	**GJITHSEJ PAGESAT E PARASË PËR AKTIVITETET OPERATIVE (1 deri 6)**		**-3,945,248.30**	**-1,408,042.00**
A	**RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE (I-II)**		**37,932.00**	**-30,778.00**
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE				
1.	Arkëtimet e parasë nga shitja e pasurive joqarkulluese, të prekshme dhe të paprekshme			
2.	Arkëtimet e parasë nga shitja e pronës dhe instrumenteve të borxhit			
3.	Arkëtimet e parasë nga interesi			
4.	Arkëtimet e parasë nga dividentat			
5.	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet investuese			
III	**GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (1 deri 5)**		**0.00**	**0.00**
1.	Pagesat e parasë për blerjen e pasurive joqarkulluese, të prekshme dhe të paprekshme			
2.	Pagesat e parasë për blerjen e pronës dhe instrumenteve të borxhit		-1,081,014.11	-1,628,219.00
3.	Pagesa tjera të parasë për aktivitetet investuese			
IV	**GJITHSEJ PAGESAT E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (1 deri 3)**		**-1,081,014.11**	**-1,628,219.00**
B	**RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE (III-IV)**		**-1,081,014.11**	**-1,628,219.00**
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUESE				
1.	Arkëtimet e parasë nga emetimi e instrumenteve financiare të borxhit dhe atyre të ekuitetit			

2.	Arkëtimet e parasë nga kryegjeja e kredisë, fleteobligacionet, huatë dhe huazimet tjera		1,081,014.11	1,461,778.00
3.	Arkëtimet tjera të parasë nga aktivitetet financuese			
V	**GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUESE (1 deri 3)**		**1,081,014.11**	**1,461,778.00**
1.	Pagesat e parasë për pagimin e kryegjësë së kredisë dhe fletëobligacioneve			
2.	Pagesat e parasë për dividenta (njohja e te hyra te grantit)			0.00
3.	Pagesat e parasë për lizingun financiar			
4	Pagesat e parasë për ri-blerjen e aksioneve vetjake të kompanisë			
5.	Pagesa tjera të parasë për aktivitetet financuese			
VI	**GJITHSEJ PAGESAT E PARASË PËR AKTIVITETET FINANCUESE (1 deri 5)**		**0.00**	**0.00**
C	**RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUESE (V-VI)**		**1,081,014.11**	**1,461,778.00**
D	**RRJEDHA NETO E PARASË (A+B+C)**		**37,932.00**	**-197,219.00**
E	**PARATË DHE EKUIVALENTËT E PARASË NË FILLIM TË PERIUDHËS**		**419,793.00**	**617,012.00**
F	**PARATË DHE EKUIVALENTËT E PARASË NË FUND TE PERIUDHËS (D+E)**		**457,725.00**	**419,793.00**
G	**RRITJA (ZVOGËLIMI) I PARASË DHE EKUIVALENTËVE TË PARASË**		**37,932.00**	**-197,219.00**

31.03.2013
F. Kosovë

Z. Betim Gjoshi
Kryeshef ekzekutiv

Z. Zair Imeri
Zyrtar kryesor financiar

IV. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

Për periudhën 01.01. **Deri** 31.12.012

Shenja e zërit	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	Shumat në euro	
			Viti vijues	Viti i kaluar
1	Kapitali i regjistruar		25,000.00	25,000.00
2	Rezervat e kapitalit		4,780,123.04	4,020,964.00
3	Fitimet e mbajtura ose humbjet e akumuluara		79,499.00	79,499.00
4	Fitimi ose humbja nga viti vijues		-470,847.19	
5	Rivlerësimi i pasurive joqarkulluese të prekshme			
6	Rivlerësimi i pasurive joqarkulluese të paprekshme			
7	Rivlerësimi i pasurive financiare në dispozicion për shitje			
8	Rivlerësime tjera			
Gjithsej kapitali dhe rezervat (1 deri 8)			**4,413,774.85**	**4,125,463.00**
9	Diferenca të kursit nga investimet neto në afarizmin në botën e jashtme			
10	Tatimet aktuale dhe të shtyra			
11	Mbrojtja e rrjedhës së parasë			
12	Ndryshimi në politikat kontabel			
13	Korrigjimi i gabimeve materiale nga periudhat paraprake			
14	Ndryshime tjera në ekuitett			
Rritja apo zvogëlimi i tërësishëm në kapital (9 deri 14)			**0.00**	**0.00**
	Vetëm për Raportet e konsoliduara			
a)	Iu takon pronarëve te kompanisë meme			
b)	I takon interesit minoritar			

31.03.2013
F. Kosovë

Z. Betim Gjoshi
Kryeshef ekzekutiv

Z. Zair Imeri
Zyrtar kryesor financiar

2 PASQYRA E POLITIKAVE KONTABËL

2.1.Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgaditur në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi të Kosovës si dhe standardet e kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.

2.2.Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyra financiare është raport financiar për qëllime të përgjithshme i cili përgatitet në pajtueshmëri ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë, me Standardet e Kontabilitetit dhe në harmoni me kërkesat e Bordit për Raportime Financiare të Kosovës, si dhe për nevoja të Menaxhmentit dhe shfrytëzuesve tjerë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me kostot historike të pasurive dhe detyrimeve për çka ka dëshmi të njaftueshme

Pasqyrat financiare janë të paraqitura ne Euro. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në pajtueshmëri me konventën e kostos historike, por nikohësisht e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe paisjeve në shumat e rivlersuara. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe poqese nuk ceket ndryshe, janë konsistente me ato që janë miratuar në vitin e kaluar financiar.
Përgaditja e pasqyrave financiare konform të SNRF kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit.Githashtu këkojnë menaxhmentit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proceset e aplikimit të politikave të kontabilitetit.
Periudha raportuese e Shoqërisë përfshinë një periudhë dymbëdhjetë mujore pra 01.Janar deri më 31 Dhjetor të çdo viti.

2.3.Valuta e këmbimit

Monedha raportuese e Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës "Trainkos" sh.a. është njësia monetare e Unionit Europian (Euro).
Transaksionet e valutës së huaj konvertohen duke përdorur normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Çfarëdo lloj përfitimesh apo humbjesh, që kanë të bëjnë me harmonizimin e shumave, të pagueshme ose të arkëtueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave. Nuk kemi hetuar të transaksioneve të tilla me vlera materiale..

2.4. Prona, impiantet dhe paisjet

Vlera e pronës , impianteve dhe paisjeve të "Trainkos" sh.a më 31.Dhjetor 2012 janë bartur në bazë të parimit të konzistencës, respektivisht vazhdimsisë së vendimit të komisionit për ndarje, sipas kostos minus zhvlersimi i aukumuluar.Kosto paraqet shpenzimin që i atribuohet direkt blerjes.
Një zë nga pajisjet dhe makineritë largohet nga bilanci i gjendjes kur shitet ose kur tërhiqet nga përdorimi dhe kur nuk pritet ndonjë benefit i ardhshëm nga ato.
Riparimet dhe mirëmbajtja ngarkohen në pasqyrën operative atëherë kur ndodhin shpenzimet.
Ngarkimi vjetor për amortizimin llogaritet duke përdorur metodën lineare për të gjitha kategoritë e pronës, toka nuk është e zhvlerësuar

Shpenzimet pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të asetit apo janë njohur si asete të ndara , në mënyrën e duhur,vetëm atëherë kur përfitimi ekonomik i mundshëm lidhur me to mund të rrjedhë në kompani dhe vlera e njetit mund të matet seriozisht.
Shkalla e zhvlerësimit të aseteve sipas pëcaktimit të vlerësuesve mbi jetën e përdorimit dallon nga shkalla e zhvlersimit sipas Rregulloreve në fuqi:
Ndërtesat.....20 vite
Inventar Hekurudhe.....5-10 vite
Automjetet .....5 vite
Pasuri tjera jo qarkulluese.....5-10 vite

PASQYRA E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)

2.5.Zhvlerësimet e aseteve

Prona, impiantet dhe pajisjet rishikohen për dëmtim kurdo që ndonjë ngjarje ose ndryshimet në bazë të rrethanave tregojnë se shuma bartëse e një aseti nuk mund të rikuperohet. Kurdo që vlera bartëse e një aseti e tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme, një humbje nga rënia në vlerë njihen në të ardhura. Vlera e rikuperueshme e një aseti është çmimi më i lart shitës neto i një aseti dhe vlera në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shuma e arritshme nga shitja e një aseti në një transaksion të vullnetit të lirë, përderisa vlera në përdorim është vlera aktuale e paraparë në të ardhmen e flukseve të parasë që pritet të arrijnë nga përdorimi i vazhdueshëm të një aseti dhe nga heqja e tij në fund të jetëgjatësisë së përdorimit të tij. Vlerat e rikuperueshme llogariten për asetet individuale ose, nëse nuk është e mundur, për njësitë që gjenerojë të holla..

2.6.Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët e licencuar për kompjuter (ALPHA). Këto fillimisht deklarohen sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluara të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metoden lineare përderisa kostoja e një aseti të paprekshëm shlyhet përgjat kohzgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

2.7.Instrumentet financiare

Asetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur kompania bëhet pjesë e dispozitave kontraktuese të instrumentit financiar. Asetet financiare nuk njihen kur të drejtat e kontraktuara mbi rrjedhën e parasë nga aseti financiar skadon, ose kur aseti financiar dhe të gjitha rreziqet e konsiderueshme dhe shpërblimet janë transferuar. Detyrim financiar nuk njihet kur ai është shuar, shlyer, anuluar apo skaduar.
Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksioneve, me përjashtim të aseteve dhe detyrimeve financiare të bartura në vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, të cilat fillimisht janë matur me vlerën e drejtë. Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur më pas ashtu si përshkruhet më poshtë.

PASQYRA E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)

2.8.Mjetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë asete financiare të mbajtura për tregti. Aseti financiar klasifikohet në këtë kategori nëse kryesisht është përvetësuar për qëllim shitje në afat të shkurtër. Asetet në këtë kategori janë klasifikuar si asete qarkulluese. Kompania nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori deri në datë të raportimit.

2.9.Kreditë dhe të arkëtueshmet

Huat dhe të arkëtueshmet janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuara në një treg aktiv. Këto janë të përfshira në asetet qarkulluese, me përjashtim të kredive dhe të arkëtueshmet që kanë maturitet në më shumë se 12 muaj që nga data e bilancit të gjendjes. Kreditë dhe të arkëtueshmet e kompanisë në datën e bilancit të gjendjes përbëhen nga të arkëtueshmet tjera dhe tregtare, paraja dhe ekuivalentët e parasë.

2.10.Stoqet

Stoqet e kompanisë "Trainkos" sh.a. janë kryesisht materiale dhe pjesët rezervë të cilat janë të lidhura kryesisht me funksionimin e transportit hekurudhor të mallrave dhe shërbimeve.Vlera e stoqeve është vlersuar me koston historike, më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme, duke përdorur metodën e matjes mesatare dhe përfshin shpenzimet e kryera në përvetësimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin ekzistues dhe gjendjen ekzistuese të tyre.

2.11.Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë bartur në shumat e faturuara siq janë reduktuar nga provizioni i bërë për dëmin e tyre. Provizioni për borgjet e këqija mund të vendoset me vendime te vlefshme, kur ka evidencë objektive se Kompania nuk do të jetë në gjendje ti mbledhë të gjitha shumat e pritura .

2.12.Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas kostos. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë së gatshme, paraja përfshinë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

2.13.Kapitali aksionarë

Kapitali aksionarë pëbëhet nga vlera monetare e kontribuar , e regjistruar në librat e Kompanisë në shumën prej 25,000.00€.

PASQYRA E POLITIKAVE KONTAB ËL(vazhdim)

2.14.Rezervat

Rezervat fillimisht janë njohur në gjendjen fillestare të bilancit të gjendjes në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitalit fillestar të kontribuar nga aksionarët e kompanisë.

2.15.Përfitimet e punëtorëve

Numri i te punësuarve në "Trainkos" sh.a. për periudhen 01.01.2012 -31.12.2012 ka variruar prej 208 deri në 225
Në rrjedhat normale të biznesit, entiteti bënë pagesat në emër të punëtorëve të vetë për kontributet pensionale dhe atimet në të ardhurat personale të cilat janë të kalkuluara në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrave të të ardhurave për periudhën e caktuar kohore.

2.16.Tatimi

"Trainkos" sh.a. është kërkuar që të paguajë tatim në fitimin e realizuar për çdo periudhë financiare kontabël të kalkuluar në përputhshmëri me rregulloret në fuqi, për periudhën e caktuar, si dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin dhe kontributet në të ardhura personale.
Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet e tatimit mund të barten për tu vendosur në pesë vitet pas vitit kur ka ndodhur humbja.

2.17.Njohja e të ardhurave operatuese

Të ardhurat e kompanisë janë kryesisht të hyra të cilat realizohen nga veprimtaria primare e entitetit transportin e mallrave dhe shërbimet hekurudhore të udhëtarëve në baza komerciale, dhe njihen në momentin e faturimit, gjegjësisht arkëtimit.
Të ardhurat njihen kur është e mundur që fitimet ekonomike lidhur me rrjedhen e transakcioneve të kompanisë dhe kur shuma e të hyrave mundë të matet besueshëm dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të kompanisë janë përmbushur. Këto kritere të njohjes së aktiviteteve-specifike janë të bazuara në mallrat ose zgjidhjet e siguruar ndaj klientit dhe kushteve të kontratës në secilin rast, dhe janë përshkruar më poshtë
Të hyrat nga kontratat me çmimeve fikse për ofrimin e shërbimeve të transportit në përgjithësi njihen në periudhën qe shërbimet janë siguruar, duke përdorur metodën drejtë-vizore mbi afatin e kontratës.

'ASQYRA E POLITIKAVE KONTABËL(vazhdim)

2.18.Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin e kryerjes së shërbimit ose në datën e aturimit.

2.19.Grantet qeveritare

Grantet nga qeveria janë njohur me vlerën reale ku është një siguri e arsyeshme se grantet do të mirren dhe compania do ti përmbush kushtet e bashkangjitura.
Grantet qeveritare lidhur me blerjen e paisjeve, pronës dhe impianteve janë të përfshira në detyrimet jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyrë dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave në bazë drejtëvizore sipas shkallës së zhvlerësimit për kategorinë e caktuar.
Grantet qeveritare që lidhen me shpenzimet janë të shtyra dhe njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave gjatë periudhës së nevojshme që të përputhen ato me shpenzimet që ato kanë për qëllim për ti compensuar.

2.20. Provizionet, detyrimet kontigjente dhe asetet kontigjente

Provizionet njihen kur detyrimet e tanishme si rezultat i një ngjarje në të kaluar mund të çojë në një fluks dalës të burimeve ekonomike nga grupi ku shumat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Koha apo shuma e daljeve mund të jetë ende e pasigurt. Një detyrim i tanishëm lind nga prania e një zotimi konstruktiv ose detyrimi ligjor që ka rezultuar nga ngjarjet e kaluara.
Provizionet maten me shpenzimet e parashikuara të nevojshme për të shlyer obligimin e tanishëm, duke u bazuar në dëshmi të besueshme në dispozicion në datën e raportimit, duke përfshirë rreziqet dhe pasiguritë lidhur me detyrimin e tanishëm. Aty ku ka një numër të detyrimeve të ngjashme, gjasat që një fluks dalës do të kërkohet në shlyerje të obligimit përcaktohet duke marrë në konsideratë klasën e detyrimeve si tërësi. Provizionet zbriten në vlerën e drejtë të tyre, kur vlera kohore e parasë është materiale.
Të gjitha provizionet rishikohen në çdo datë të raportimit dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual.

'ASQYRA E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)

:.22.Detyrimet kontigjente

Detyrimet kontingjente janë njohur në pasqyrat financiare. Si detyrim kontigjent shpalosen paditë e të ɔunësuarve si kërkesa potenciale ndaj kompanisë në vlerë të përafërt rreth 250 mijë euro, e trashëguar me rastin e ndarjes nga Hekurudhat e Kosovës Sh.A.

2.23.Pasuritë kontigjente

Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një fluks hyrës i përfitimeve ekonomike është i mundshëm.
Shuma e një humbje kontingjente njihet si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë që, ɔjë detyrim ka ndodhur deri në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlerësim i arsyeshëm i humbjes së shkaktuar mund të bëhet.

3.Menaxhimi i riskut financiar dhe kapital

Menaxhimi financiar i riskut të kompanisë bartet nga bordi i drejtorëve.
Objektivat e kompanisë kur menaxhojnë me kapital janë të ruajnë mundësinë që kompania të vazhdoj me punë në të ardhmen.

3.1.Risku kreditor

Mjetet financiare të cilat e vënë kompaninë në risk kreditor përbëhen prej parasë në dorë dhe parasë në llogaritë bankare.
Paraja dhe ekuivalentët e parasë të kompanisë përbëhen kryesisht nga salldot bankare.

3.2.Analiza e riskut të kredisë

Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit, të përmbledhura si më poshtë:

Të arkëtueshmet dhe të tjera	31.Dhjetor 2012
Të arkëtueshmet tregtare	1,671,908
Paraja dhe ekuivalentet	457,725
Total	**2,129,633**

.3. Risku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet inanciare, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parasë nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, në bazë ditore dhe javore, si edhe në bazë të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Nevojat e likuiditetit afatgjatë për një periudhë në vrojtim prej 180 ditësh dhe 360 ditësh identifikohet çdo muaj. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepricë apo ndonjë mungesë. Kjo analizë tregon se mundësitë e huamarrjes në dispozicion pritet të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në vrojtim.
Kompania mban të holla për të përmbushur kërkesat e likuiditetit minimum për periudhën 30-ditore. Financimi i nevojave për likuiditet afatgjatë është një siguri shtesë për kompani.

3.4 Politikat dhe procedurat e menaxhimit të kapitalit

Objektivat e kompanisë për menaxhimin e kapitalit janë për të ruajtur aftësinë e kompanisë që të vazhdoj aktivitetin mbi parimin e vazhdimësisë në mënyrë që të sigurojë kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të zvogëluar koston e kapitalit.

Në mënyrë që të ruajë ose të përshtat strukturën e kapitalit, kompania mund të rregullojë shumën e dividendëve të paguar për aksionarët, kthimi i kapitalit tek aksionarët, të emetoj aksione të reja ose të shesë asete për të reduktuar borxhin.

3.5. Instrumentet financiare sipas kategorive

Vlerat bartëse të aseteve dhe detyrimeve financiare të kompanisë të njohura në datën e bilancit të gjendjes të periudhës së raportuese nën vështrim gjithashtu mund të kategorizohet si në vijim:

(në EUR)

Asetet financiare **Kreditë dhe të arkëtueshmet**	**Më 31 Dhjetor 2012**
- Të arkëtueshmet tregtare dhe tjera	1,671,908,00
- Paraja dhe ekuivalentët e saj	457,725.00
Totali	**2,129,633.00**
Detyrimet financiare	
Detyrimet financiare të matura në koston e amortizimit	
Qarkulluese	
- Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	828,008.82
Totali	**828,008.82**

.VLERËSIMET DHE GJYKIMET KRITIKE TË KONTABILITETIT

Në zbatimin e politikave të kontabilitetit të kompanisë, të cilat janë përshkruar në Shënimin 2, menaxhmenti kërkohet të bëj gjykime, vlerësime dhe supozime lidhur me shumat bartëse të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk anë paraqitur nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të jenë të rëndësishme. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet janë shqyrtuar në një bazë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve të kontabilitetit njihet në periudhën në të cilën vlerësim është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon si në periudhën e tanishme dhe në të ardhshmen.

4.1.Vlerësimi i pasigurisë

Zhvlerësimi

Kurdo që shuma bartëse e një aseti ose një njësi gjeneruese të hollash e tejkalon shumën e rikuperueshme të tij, një humbje nga rënia e vlerë duhet njohur. Kur përcaktohet shuma e rikuperueshme, Menaxhmenti vlerëson pritjet e flukseve të parasë nga secila njësi gjeneruese-të hollash dhe përcakton normën e interesit për llogaritjen e vlerës aktuale të rrjedhjes së parasë.

Jeta e dobishme e aseteve të zhvlerësueshme

Menaxhmenti rishikon jetën e dobishme të aseteve të zhvlerësueshme në çdo datë të raportimit. Më 31 Dhjetor 2012, menaxhmenti vlerëson se jeta e dobishme përfaqëson pritjet e përfitimeve nga asetet për kompaninë. Shumat bartëse janë analizuar në Shënimin 5 Rezultatet aktuale, megjithatë, mund të ndryshojnë për shkak të vjetrimit teknik.

5.PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Toka	Ndërtesat	Inventar hekurudhe	Automjetet	Pajisje tjera	Totali
KOSTO	**(Euro)**	**(Euro)**	**(Euro)**	**(Euro)**	**(Euro)**	**(Euro)**
Më 1 Janar 2012	229,680	1,496,804	13,658,989	115,017	213,766	15,714,256
Shtesat gjatë vitit	-	91,787	-	-	93,149	184,936
Shlyerjet	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2012	**229,680**	**1,588,591**	**13,658,989**	**115,017**	**306,915**	**15,899,192**
ZHVLERËSIMI						-
Më 01 Janar 2012	-	559,533	7,577,122	28,831	51,455	8,216,941
Zhvlerësimi për vitin	-	53,528	585,220	16,431	64,837	720,016
Eliminimet në shlyerje	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2012	**-**	**613,061**	**8,162,342**	**45,262**	**116,292**	**8,936,957**
VLERA E BARTUR NETO						
Më 31 Dhjetor 2012	**229,680**	**975,530**	**5,496,647**	**69,755**	**190,653**	**6,962,235**
Më 1 Janar 2012	**229,680**	**934,271**	**6,081,867**	**86,186**	**179,582**	**7,511,586**

6.STOQET

	Më 31 Dhjetor 2012
Pjesë rezervë të lokomotivave, trena dhe vagona	501,350
Nafta dhe vajra	68,898
Depo e Administrates	52,084
Totali i stoqeve	**622,331.93**

Stoqet maten në koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Në vlerësimin e vlerave neto të realizueshme, dëshmitë më të besueshme / të dhënat në dispozicion në kohën e vlerësimeve të bëra merren parasysh/.

7.TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

	Më 31 Dhjetor 2012
Të arkëtueshmet tregtare:	
Të arkëtueshmet nga transporti i mallrave	1,671,908
	1,671,908
(Zbritur për): Provizion për zhvlerësim	
	1,671,908
Të arkëtueshmet tjera afatshkurta:	
Tatimi i parapaguar	4,728.56
Kërkesat tjera	103,581.28
Totali i të arkëtueshmeve tregtare dhe tjera afatshkurta	**1,780,218**

8.PARAJA DHE EKUVLAENTET E PARASË

	Më 31 Dhjetor 2012
Kapitali themelues- llogari	25,000
Paraja në bankë në llogaritë rrjedhëse	431,923
Paraja në arkë	802
Totali i parasë në arkë dhe në banka	**457,725**

9.EKUITETI

Kapitali aksionar

Më 16 Gusht 2011 datën e regjistrimit dhe sipas Regjistrimit të Biznesit të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë më datë 23 Gusht 2011 me numër regjistrimi të biznesit 70773120, kapitali i përgjithshëm i regjistruar kap shumën e 25,000 Euro. Ai përbëhet nga 25 mijë aksione të zakonshme me çmim prej 1 euro për aksion.

Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ka të drejtën ekskluzive për të ushtruar të drejtat e aksionarit mbi ndërmarrjet në pronësi publike.

Kapitali aksionar

Në datën efektive të inkorporimit/themelimit me 1 Shtator 2011 nga Hekurudhat e Kosovës Sh.A. janë transferuar tek TRAINKOS sh.a. asete në vlerën e tyre kontabël sipas marrëveshjes ndërmjet TRAINKOS sh.a.dhe INFRAKSOS sh.a.. Gjithashtu në vlerën e kapitalit janë të përfshira edhe provizionet për vagonët e dëmtuara në territorin e Kosovës të cilat kanë qenë në pronësi të shteteve/republikave të ish Jugosllavisë në vlerë prej 1,500,000 Euro këto obligime i ka marr përsipër Qeveria e Kosovës me vendim Nr. 05/110 të datës 26 Shkurt 2010 mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës sh.a. në TRAINKOS sh.a. dhe INFRAKOS sh.a.

10. DETYRIMET PËR GRANTE

Më 31 Dhjetor 2012 balanca e llogarisë së grantit të shtyrë paraqet asetet e ndryshme të kompanisë, të tilla si infrastruktura dhe inventari hekurudhor, prokurimi i të cilave ishte financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK).

Tabela në vijim jep gjendjen fillestare te detyrimit per grante dhe lëvizjet e llogarisë së grantit të shtyrë gjatë periudhes 01. Janar deri me 31.Dhjetor 2012.

	Më 31.12.2012
Më 01 Janar	**4,897,734**
Korrigjimi i granteve për efektet në themelim të kompanisë	(567,007)
Grantet e pranuara:	
- në para të gatshme për shpenzime kapitale	1,081,014
Te hyrat e njohura nga grantet e shtyra për vitin	(567,007)
Më 31 Dhjetor 2012	**5,411,741**

11.TË PAGUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

	Më 31.12.2012
	(në EUR 000)
Të pagueshmet tregtare	699,940
- Furnitorët lokal	699,940
Të pagueshmet tjera afatshkurtra	87,723
Të pagueshmet tjera	87,723
Totali i të pagueshme tregtare dhe të tjera	**787,174**

12.PROVIZIONET

Balanca e provizioneve të Kompanisë, e cila më 31 Dhjetor 2012 në shumë prej 250 mije Euro ka të bëj me kërkesat për kompensim prej punëtorëve të mëparshëm që kanë humbur punën. Këto shuma të provizioneve janë bërë dhe janë të përllogaritura në bilancin e gjendjes për artikujt që mund të shfaqen.

13.TË ARDHURAT OPERATIVE

	Më 31 Dhjetor 2012
Transporti i mallrave komerciale	2,439,051
Trafiku i udhëtarëve	1,666,062
Shërbime te vagonit dhe dëmshpërblimet për mos ngarkesë me kohë	237,068
Të ardhura nga grantet(zvoglim i te ardhurave te shtyera)	567,007
Të ardhura tjera	142,821
Gjithsejt të ardhurat	**5,052,629**

14. KOSTO E SHËRBIMEVE TË OFRUARA

	Më 31 Dhjetor 2012
Zhvlerësimi	720,016.19
Qasja në Binar (INFRAKOS)	1,370,690.00
Shpenzimet e personelit (Shënimi 18)	1,382,906.00
Shpenzimet e karburantit	1,245,171.00
Tërheqja e trenave	214,819.00
Shpenzimet e mirëmbajtjes	115,777.00
Shpenzimet e transportit	85,705
Shpenzimet tjera	388,392.00
Total kosto e shërbimeve të ofruara	**5,523,476.19**

15.SHPENZIMET E PERSONELIT

	Më 31 Dhjetor 2012
Pagat neto	1,297,364
Kontributet e detyrueshme	85,542
Kompensimet tjera	-
Totali i shpenzimeve të personelit	**1,382,906**

Gjithsej numri i punëtorëve të Kompanisë me 31 Dhjetor 2012 ishte 225.

15.1.Procedimet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2012, proceset gjyqësore të ngritura kundër kompanisë arrijnë shumën prej 250,000 mijë Euro. Që nga data e bilancit të gjendjes të këtyre pasqyrave financiare, nuk ka ndonjë provizion te regjistruar për humbjet potenciale, sa i përket procedimeve gjyqësore. Menaxhmenti i kompanisë, vazhdimisht analizon riskun potencial që rezulton nga humbja lidhur me procedimeve gjyqësore, gjatë procedimit dhe pretendimet e mundshme kundër kompanisë, që mund të ngritën në të ardhmen. Ndonëse përfundimi i këtyre çështjeve nuk mund gjithmonë të pohohet me precizitet, menaxhmenti i Kompanisë beson që nuk ka mundësi të rezultojë ndonjë detyrim material.

16.NGJARJET PASUESE

Pas 31 Dhjetorit 2012 dhe data raportuese deri në miratimin e këtyre raporteve financiare, nuk ka ngjarje të përshtatjes të reflektuar në pasqyrat financiare apo ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për shpalosje në këto pasqyra financiare.

17.FUSHËVEPRIMI- OBJEKTIVI DHE SHTRIRJA E AUDITIMIT

Auditimi është përformuar në harmoni me SNA. Standardet e përmendura kërkojnë që ne të planifikojmë dhe ekzekutojmë auditimin në mënyrë që të nxjerret një siguri e arsyeshme se gjendjet e prezentuara në Pasqyrat Financiare nuk kanë pasur keqpohime materiale apo ndryshime. Auditimi jonë përmbanë hulumtimin e informatave të mbledhura të rëndomta për të vërtetuar shumat dhe informatat e prezentuara në raportin financiar. Po ashtu përmbanë hulumtimin dhe mendimin mbi politikat e kontabilitetit të cilat janë aplikuar, duke i dhënë rëndësi të veçant, se si janë bërë ato nga menaxhmenti, dhe hulumtimi mbi prezentimin gjeneral të kontove të shoqerisë.

17.1.Sigurimi i dëshmive dhe testeve gjatë procesit të Auditimit

Në kompaninë " Trainkos" sh.a. kemi kryer një sërë testesh përmes mostrave të dëshmive autentike. Punën e testimit dhe sigurimit të dëshmive kryesisht e kemi zhvilluar me ndihmën e stafit të entitetit ku do të prezentojmë disa prej dëshmive dhe mostrave të zgjedhura nga arkivi i librave të kontabilitetit dhe dokumentacionit tjetër që janë shfrytëzuar gjatë auditimit.

- Statuti i entitetit
- Vendimet e ndarjes
- Rregulloret
- Manualet
- Marrëveshja në mes të entitetit dhe të punësuarëve të rregullt dhe kontraktorëve/
- Dokumentet e kontabilitetit të cilat janë subjekt i auditimit
- Pasqyrat financiare dhe të aktiviteteve lidhur me biznesin
- Shpalosjet e pasqyrave financiare
- Çdo dokument tjetër i cili ka të bëjë me kompaninë

17.2.Njohja dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe sistemit të kontabilitetit

- Kemi zgjedhur strategjinë e mosbesimit apo (testeve të pavarura) në kontrollin e brendshëm. Kemi bërë biseda me nivelin e duhur të menaxhmentit, mbikëqyrësve dhe personelit tjetër, inspektimi i dokumentacionit, raporteve dhe dosjeve elektronike. Kemi vëzhguar aplikimin e kontrolleve të veçanta të brendshme
- Gjatë procedurave audituese, në bazë të asaj që kemi arritur të shohim, mund të konstatojmë se këtu kontrollohen raportet financiare nga disa nivele duke filluar nga kontabilisti, mbikqyrësit ,e menaxherët si dhe bordi i drejtorëve.